



**REPUBLIKA E MAQEDONI SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr. 03-214**  
**16.06.2023**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 53 paragrafi (2) nga Ligji i njëjtë, pika 4 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10 -2216/1 datë 23.5.2023, dhe në pajtim me Konkluzionin ark.nr. 02-2414/5, datë 15.6.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 19- të mbajtur më 15.6.2023, miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) ALSAT-M SHPK, Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), në mënyrë që në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 8 maj 2023, në edicionin reprizë të emisionit informativ "Pasqyra e shëndetit" (Ogledallo na zdravjeto) emision i specializuar shëndetësor, ka transmetuar komunikim të fshehtë komercial për spitalin "Sveti vid".

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-2216/1 datë 23.5.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET TRD ALSAT-M SHPK Shkup, që menjëherë pas pranimit të këtij Aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

**Arsyetim**

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të pakove programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit me dispozitat nga ligji i përmendur, lejeve, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur është kryer shkelje apo shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe aktet nënligjore miratuar në bazë të ligjit, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Neni 53 paragrafi (2) nga LSHMAAV përcakton se nuk lejohen komunikime të fshehta komerciale audiovizuale.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 23 maj 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR ALSAT-M SHPK Shkup, transmetuar më 8 maj 2023 në nivel shtetëror, nga ku është konstatuar shkelja e nenit 53 paragrafi (2) nga LSHMAAV (komunikim i paligjshëm i fshehtë komercial audiovizual) Përkatësisht, nga mbikëqyrja është konstatuar se në reprizën e edicionit të emisionit informativ "Pasqyra e shëndetit" (Ogledallo na zdravjeto), emision special me tematik për shëndetin, përmes një bisede me Svetozar Dragoviç – themelues dhe drejtor i spitalit "Sveti Vid", si dhe nëpërmjet shtojcave në të cilat pacientët thonë fjalë lavdëruese për mjekët dhe spitalin, është bërë prezantim komercial i

spitalit, respektivisht emisioni përmban komunikime të fshehta komerciale audiovizuale, të detajuara në pikën 7, Konstatimet nga mbikëqyrja, në rubrikën - Deklarata për ilustrim të Raportit me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-2216/1 datë 23.5.2023, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në bazë të nenit 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR ALSAT-M SHPK Shkup më 29.5.2023, dërgoi shkresë – Raport me shkrim nga mbikëqyrja për deklarim ark.nr.10-2216 /2 datë 29.5.2023, me të cilin ka dorëzuar lëndën Raport me shkrim, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoi deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi, për të cilin në afatin e paraparë, më 31.5.2023, SHTR ALSAT-M SHPK Shkup ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit, Nr.y në ark.10-2216/3 datë 31.5.2023. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 15.6.2023, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim, konstatoi se SHTR ALSAT-M SHPK Shkup t'i shqiptohet masë – vërejtje publike .

Rrjrdhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 53 paragrafi (2) nga Ligji i njëjtë, pika 4 dhe 14 nga Udhëzimi për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022 dhe Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2216/1 datë 23.5.2023, për konstatimit të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 19- të mbajtur më 15.6.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-2414/5 datë 15.6.2023, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron SHTR ALSAT-M SHPK Shkup dhe e udhëzon menjëherë pas pranimit të aktvendimit që të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

#### **Shtojca (1):**

- Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-2216/1 datë 23.5.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.